

20051131560

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR SIGURIMIN E
OBLIGUESHËM PENSIONAL ME FINANCIM KAPITAL

Neni 1

Në Ligjin për sigurimin e obligueshëm pensional me financim kapital (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 29/2002, 85/2003 dhe 40/2004), në nenin 13 paragrafi (1) pika zëvendësohet me presje dhe shtohen fjalët: “me ç’rast obligohet që të mbajë mjete likuide në shumë jo më të vogël nga përqindja e kapitalit themelues, të cilin e përcakton Agjencia”.

Neni 2

Në nenin 20 paragrafi (1) pika a) pas fjalës “fondet” shtohen fjalët: “përveç shkresave dhe obligacioneve shtetërore të emetuara nga Republika e Maqedonisë”.

Pas pikës v) shtohet pikë e re g), si vijon:

“g) blerjen ose shitjen e letrave me vlerë, nëse me tregtimin e këtillë do të pamundësohej blerja ose shitja e letrave me vlerë me mjetet e fondit pensional ose, nëse blerja ose shitja e letrave me vlerë me mjetet e fondit pensional do të realizohej me kushte më të pavolitshme për fondin pensional.”

Neni 3

Në nenin 38 shtohet paragrafi i ri (5), si vijon:

“(5) Agjencia më afërsisht e rregullon procedurën për tërheqjen ose heqjen e lejes për administrimin me fondin pensional nga paragrafi (1) i këtij neni”.

Neni 4

Në nenin 58 paragrafi (3), shtohet fjalia e re si vijon:

“Agjencia për shkaqe të arsyeshme, mund ta vazhdojë afatin për zgjedhje më së shumti për dymbëdhjetë muaj”.

Në paragrafin (7) fjalët: “vullnetarisht do të anëtarësohet në” zëvendësohen me fjalët: “bëhet anëtar i”.

Në paragrafin (9) fjalët: “obligohen që të nënshkruajnë marrëveshje për anëtarësi me shoqërinë e cila administron me” zëvendësohen me fjalët: “bëhen anëtarë të”, ndërsa fjalia e dytë fshihet.

Neni 5

Në nenin 59 në paragrafin (4) fjalët: “selia e” fshihen.

Neni 6

Në nenin 65 pas paragrafit (2) shtohet paragrafi i ri (3), si vijon:

“(3) Dispozitat nga paragrafët (1) dhe (2) këtij neni, zbatohen në mënyrë përkatëse edhe për të siguruarit e sistemuar përkohësisht nga neni 58 paragrafi (7) i këtij ligji.”

Neni 7

Në nenin 66 pas paragrafit (3) shtohet paragrafi i ri (4), si vijon:

“(4) Dispozitat nga paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij neni, zbatohen në mënyrë përkatëse edhe për të siguruarit e sistemuar përkohësisht nga neni 58 paragrafi (7) i këtij ligji.”

Neni 8

Në nenin 67 pas paragrafit (3) shtohet paragrafi i ri (4), si vijon:

“(4) Dispozitat nga paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij neni, zbatohen në mënyrë përkatëse edhe për mjetet e nënlllogarisë individuale të llogarisë së veçantë në fondin pensional, nga neni 68 paragrafi (2) i këtij ligji.”

Neni 9

Në nenin 68 paragrafi (2) fjala “paragrafët” zëvendësohet me fjalën “paragrafin” dhe fjalët: “dhe (9)” fshihen.

Neni 10

Në nenin 85 paragrafi (3) ndryshon si vijon:

“Përlllogaritjet nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni i kryen shoqëria dhe ato janë lëndë e kontrollit e Agjencisë”.

Neni 11

Në nenin 96 paragrafi (1) pikat a) dhe b) ndryshojnë si vijojnë:

“a) Raportet financiare tremujore të pareviduara dhe vjetore të reviduara për shoqërinë;
b) Raportet themelore tremujore të pareviduara financiare dhe raportet plotësuese dhe raportet vjetore të reviduara financiare dhe raportet plotësuese për fondin pensional.”

Në pikën zh) fjala: “paragrafi” zëvendësohet me fjalët: “paragrafët (1) dhe”.

Neni 12

Neni 97 ndryshohet si vijon:

“Të dhënat për zbatimin e kompetencave të Fondit për sigurimin pensional dhe invalidor të Maqedonisë të përcaktuara me këtë ligj, do të këmbehen në mënyrë reciproke ndërmjet Fondit dhe shoqërisë në bazë të marrëveshjes.”

Neni 13

Në nenin 101 pas paragrafit (2) shtohen dy paragrafë të rinj (3) dhe (4), si vijojnë:

“(3) Për shkak të sigurimit të konkurrencës nga paragrafi (2) i këtij neni, shoqëria zgjedh agjenci brokere nga vendi në bazë të provizionit më të ulët, në procedurë dhe mënyrë të përcaktuara nga Agjencia.

(4) Agjencia jep pëlqim për marrëveshjen e lidhur ndërmjet shoqërisë dhe agjencive brokere. Me marrëveshjen shoqëria në Agjenci e paraqet edhe tarifën për provizionet brokere.”

Neni 14

Në nenin 105 paragrafi (1) në pikën gj) pas fjalëve: “Komisioni për letra me vlerë i Republikës së Maqedonisë” shtohen fjalët: “nga shoqëritë aksionare të vendit, të cilat nuk janë fonde investuese të mbyllura dhe”.

Pika e) ndryshon si vijon:

“Obligacionet e emetuara në bazë të lejes nga Komisioni për letrat me vlerë të Republikës së Maqedonisë, nga shoqëritë aksionare të vendit, të cilat nuk janë banka dhe të cilat kuotojnë në tregun zyrtar të bursës së letrave afatgjate me vlerë ose në tregun tjetër të organizuar të letrave me vlerë në Republikën e Maqedonisë, që e kontrollon Komisioni”;

Në pikën zh) pas fjalës: “Maqedonisë” shtohen fjalët: “të cilat nuk janë banka”.

Në paragrafin (3) pika b) fjalët: “letra me vlerë” zëvendësohen me fjalën: “instrumente”.

Pas paragrafit (3) shtohet paragrafi i ri (4) si vijon:

“(4) Shoqëria e njofton Agjencinë për instrumentet në të cilat planifikon që t’i investojë mjetet e fondit pensional me të cilin administron, ndërsa Agjencia mban evidencën e instrumenteve të lejuara financiare për investimin e mjeteve të fondit pensional.

Neni 15

Në nenin 110 paragrafi (1) në pikat a) dhe b), pas fjalës: “të rregulluar” shtohen fjalët: “dhe të institucionalizuar”.

Neni 16

Në nenin 130 paragrafi (1) pika 6 pas fjalëve: “kapitalit të paguar” shtohen fjalët: “dhe nuk mban mjete likuide në shumën jo më të vogël se përqindja e kapitalit themelues”.

Neni 17

Në nenin 139-a në paragrafin (2) në rreshtin e gjashtë dhe të dhjetë pas fjalës “pronës” shtohen fjalët: “të fondeve pensionale”.

Neni 18

Në nenin 139-b paragrafi (1) pas numrit “116” vihet presje dhe numri “dhe 122” zëvendësohet me fjalët: “117 paragrafi (1), 118 paragrafi (3), 119 paragrafi (2), 121, 122 dhe 123”.

Paragrafi (2) ndryshon si vijon:

“Anëtari i Këshillit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë ose i punësuar në Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë, nuk mund të jetë anëtar i organeve të administrimit ose i punësuar në shoqëri.”

Pas paragrafit (3), shtohet paragrafi i ri (4) si vijon:

“(4) Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë në kryerjen e rolit të ruajtësit të pronës së fondeve pensionale, i kryen punët si vijon:

a) i ruan në mënyrë të sigurt mjetet e fondit pensional;

b) për ruajtjen e mjeteve të fondit pensional, në emër të vet, e për llogari të fondit pensional, hap: llogari të veçantë në Depozitorin qendror të letrave me vlerë, në të cilin i mban mjetet e investuara në letrat e vendit me vlerë, llogari të veçanta në banka, të cilat kanë leje nga Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë për mjetet e investuara në depozitime bankare dhe llogari të veçantë në subruajtës të pronës për mjetet e investuara në letrat e huaja me vlerë;

v) hap dhe mban llogari të veçanta në denarë dhe deviza në të, për barazimin e transaksioneve për investimin e mjeteve të fondit pensional dhe i ruan dokumentet për barazim lidhur me pagesën dhe arkëtimin e mjeteve në para nga dhe në ato llogari;

g) punon si ndërmjetësues për barazim në bazë të urdhëresave nga shoqëria, i grumbullon dhe arkëton hyrjet nga dividendat, kamatat dhe të gjitha hyrjet e tjera që rezultojnë nga depozitimi i mjeteve në fondin pensional;

d) siguron se instrumentet financiare të shënuara në urdhëresat e investimit të marra nga shoqëria, përmbahen në evidencën nga paragrafi (4) i nenit 105 të këtij ligji dhe se realizimi i transaksioneve është në pajtim me urdhëresat;

gj) bashkëpunon dhe kryen mbikëqyrjen e subrojtareve të pronës

e) përcjell përlllogaritjet, pagesat dhe kërkesat për zvogëlimin, lirimin e përsëritjen dhe pagesën e tatimit në dhe nga shoqëritë.

zh) i përcjell njoftimet për ngjarjet korporative deri te shoqëritë.“

Neni 19

Pas nenit 139-v shtohen katër nene të reja 139-g, 139-d, 139-gj dhe 139-e, si vijojn:

“139-g

(1) Për marrëveshjen për ruajtjen e pronës, të lidhur ndërmjet shoqërisë dhe Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë si ruajtëse e pronës së fondeve pensionale, sipas nenit 119 paragrafi (1) i këtij ligji, paraprakisht jep pëlqim Agjencia.

(2) Nëse shoqëria nuk vepron sipas marrëveshjes për ruajtjen e pronës, Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë si ruajtëse e pronës së fondeve pensionale, e njofton Agjencinë e cila merr masa sipas nenit 38 të këtij ligji në afat që nuk mund të jetë më i gjatë se 90 ditë.

(3) Me përjashtim, për shkaqe të arsyeshme, Agjencia mund ta vazhdojë afatin nga paragrafi (2) i këtij neni, me pëlqimin paraprak të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë.

(4) Nëse në afatin nga paragrafi (2) i këtij neni, shoqëria nuk i plotëson obligimet e saja nga marrëveshja, Agjencia ia heq lejen për administrimin me fondin pensional shoqërisë dhe merr kontrollin e drejtpërdrejtë të mjeteve me fondin pensional.

(5) Me marrjen e kontrollit të drejtpërdrejtë ndaj mjeteve të fondit pensional, Agjencia i merr të gjitha të drejtat dhe obligimet e shoqërisë nga marrëveshja për ruajtjen e pronës deri në zgjedhjen e shoqërisë së re.”

Neni 139-d

(1) Për kryerjen e punëve ruajtës të fondeve pensionale, Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë dhe Agjencia shkëmbejnë informata dhe të dhëna.

(2) Dinamikën, përmbajtjen dhe formën e të dhënave dhe të informatave të paragrafit (1) të këtij neni rregullohen me marrëveshje ndërmjet Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë dhe Agjencisë.

139-gj

Nëse, sipas nenit 139-a paragrafi (2) i këtij ligji, Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë rolin e ruajtësit të pronës së fondeve pensionale e bart në bankë, mjetet e fondit pensional dhe evidenca e përgjithshme dhe dokumentacioni lidhur me punët që Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë i kryen si ruajtëse e pronës së fondeve pensionale, barten te ruajtësi i ri i pronës në afatin për të cilin do të merren vesh Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë dhe ruajtësi i ri i pronës së fondeve pensionale, por jo më vonë se 30 ditë pune pas lidhjes së marrëveshjes ndërmjet ruajtësit të ri të pronës së fondeve pensionale dhe shoqërisë.”

139-e

Dispozitat nga nenet 90 dhe 91 të këtij ligji zbatohen pas kalimit të 5 viteve, duke llogaritur nga data kur do të fillojë arkëtimi i kontributit në sigurimin e obligueshëm pensional me financim kapital, në pajtim me nenin 58 paragrafi (4) i këtij ligji”.

Neni 20

Autorizohet Komisioni juridiko-ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë të përcaktojë tekst të spastruar të Ligjit për sigurimin e obligueshëm pensional me financim kapital.

Neni 21

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e botimit në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.